



Ekzaminimi i
pranimit në shkollë

Ekzaminimi mjekësor i pranimit në shkollë

Ky ekzaminim falas shërben për përkujdesjen ndaj shëndetit.

Ekzaminimi i pranimit në shkollë ofron mundësinë që fëmija përveç ekzaminimit të përcaktimit të hershëm U9 të ekzaminohet edhe një herë tjetër.

Në moshën ndërmjet 60 dhe 64 muajsh për të gjithë fëmijët është parashikuar U9 tek pediatri ose mjeku i familjes. Si U9 ashtu edhe ekzaminimi i pranimit në shkollë janë të rëndësishme.

- Gjatë U9 duhet të dallohen sëmundje akute dhe kronike si dhe vonesat në zhvillimin e fëmijës.
- Ekzaminimi i pranimit në shkollë duhet të sqarojë nëse fëmija përmbush kërkesat e jetës së përditshme shkollë në aspektin shëndetësor.

Ekzaminimi i pranimit në shkollë përmban deri në dy pjesë përbërëse:

- skanimin e pranimit në shkollë për të gjithë fëmijët në
- veçanti: një ekzaminim mjekësor në shkollë

Prindërit marrin në lidhje me pjesëmarrjen në ekzaminimin e pranimit në shkollë një njoftim të cilin duhet ta paraqesin në shkollë.

Ekzaminimi i pranimit në shkollë është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët të cilët janë të detyruar të fillojnë shkollën në vitin pasardhës shkollor.

Kush e ekzaminon fëmijën?

Ekzaminimi mjekësor i pranimit në shkollë kryhet nga specialistë të mjekësisë sociale.

Ekzaminimi mjekësor në shkollë kryhet nga një mjekë/një mjek i inspektoriatit të shëndetësisë. Rast pas rasti për këtë gjë mund të jetë i nevojshëm një takim i dytë.

Ekzaminimi i hyrjes në shkollë

- Specialisti i mjekësisë sociale regjistron historinë shëndetësore, peshën dhe gjatësinë e fëmijës.
- Aftësia për të shikuar dhe për të dëgjuar e fëmijës kontrollohet me pajisje speciale.
- Ekzaminohet zhvillimi gjuhësor dhe motorik i fëmijës. Për këtë gjë fëmijës i parashtrohen disa detyra (për shembull që të përsëris diçka me të folur ose të vizatojë diçka).
- Specialisti i mjekësisë sociale shikon librin e vaksinimit në mënyrë që të dallojë ndonjë boshllëk në vaksinim.
- Me ndihmën e broshurës së verdhë, ajo mund të përcaktojë se cilat ekzaminime U janë kryer.



Kur duhet të kryejë ekzaminimin mjekësor një fëmijë?

Një fëmijë duhet të kryejë një ekzaminim shkollor mjekësor

- nëse nuk ofrohet dëshmia e ekzaminimit më të fundit që është për moshën e tij
- të cilën mjeku i shkollës e konsideron të nevojshme.

Përveç kësaj, një ekzaminim shkollor mjekësor është i mundur me kërkesë të prindërve (p.sh. nëse ka raste në lidhje me shtyrjen ose regjistrimin e hershëm në shkollë).

Përparësitë e ekzaminimit mjekësor të hyrjes në shkollë

Për fëmijën:

Aftësia për të shikuar dhe për të dëgjuar kontrollohen në mënyrë që fëmija të jetë i aftë ta ndjekë mësimin që në fillim në mënyrë të përsosur. Shpesh, në rast se ekzistojnë probleme, mund të ofrohet ndihmë në mënyrë të shpejtë dhe të thjeshtë, si duke mbajtur syze ose duke e ulur fëmijën në vendet e para në klasë.

P.sh. nëse tek një fëmijë zbulohen vonesa në zhvillimin gjuhësor ose motorik, atëherë një gjë e tillë i bëhet me dije prindërve dhe ato këshillohen në lidhje me mundësitë nxitëse.

Shpesh harrohen vaksina dhe fëmija nuk posedon mbrojtjen e mjaftueshme me vaksina. Vaksinat e munguara, pas një konsulte në lidhje me vaksinat mund të bëhen më vonë tek pediatri ose mjeku i familjes.

Për prindërit:

Prindërit nganjëherë nuk janë të sigurt nëse duhet ta fusin në shkollë fëmijën e tyre apo jo, sidomos kur bën pjesë tek më të vegjlit e brezit të vet. Për këto prindër informacionet nga rezultatet e ekzaminimit në shkollë janë një ndihmë shtesë e dobishme për vendimmarrjen e tyre.



Çfarë duhet të dini tjetër:

Pjesëmarrja në ekzaminimet e përcaktimit të hershëm U1 deri në U9 është e detyrueshme me ligj për të gjithë fëmijët në përputhje me nenin 11 GDG (Ligji për shërbimin e shëndetësisë dhe mbrojtjen e konsumatorit) që prej datës 16.5.2008.

Kujtohuni në kohë që të kryeni ekzaminimin e përcaktimit të hershëm U9.

Nëse refuzohet pjesëmarrja në ekzaminimin mjekësor të pranimit në shkollë, departamenti i shëndetësisë është i detyruar të informojë zyrën e mirëqenies së të rinjve sipas nenit 12 të Ligjit të Shërbimit Shëndetësor dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Ekzaminimi mjekësor i pranimit në shkollë është një ekzaminim i detyrueshëm në të gjitha shtetet federale gjermane.

Informacione të mëtejshme dhe kërkesat ligjore mund të gjenden në:

www.lgl.bayern.de/schuleingangsuntersuchung



Ne i urojmë të gjithë atyre që shkojnë në shkollë për herë të parë që tani një start të mirë dhe kënaqësi dhe suksese me mësimet!

Vula e inspektoriatit shëndetësor:

- Herausgeber:** Bayerisches Landesamt für
Gesundheit und Lebensmittelsicherheit (LGL)
Eggenreuther Weg 43, 91058 Erlangen
- Internet:** www.lgl.bayern.de
- E-Mail:** poststelle@lgl.bayern.de
- Telefon:** 09131 6808-0
- Telefax:** 09131 6808-2102
- Bildnachweis:** Bayerisches Landesamt für
Gesundheit und Lebensmittelsicherheit (LGL)
Titel: Fotolia.com © Picture-Factory,
außen links: Fotolia.com © weedeznig,
innen Mitte: Fotolia.com © cre077,
innen rechts: Fotolia.com © famveldman
- Stand:** Juni 2023
- Druck / Online:** Gutenberg Druck + Medien GmbH, Uttenreuth
- © LGL, alle Rechte vorbehalten. Gedruckt auf Papier aus 100 % Altpapier

Diese Druckschrift wird kostenlos im Rahmen der Öffentlichkeitsarbeit der Bayerischen Staatsregierung herausgegeben. Sie darf weder von den Parteien noch von Wahlwerbern oder Wahlhelfern im Zeitraum von fünf Monaten vor einer Wahl zum Zweck der Wahlwerbung verwendet werden. Dies gilt für Landtags-, Bundestags-, Kommunal- und Europawahlen. Missbräuchlich ist während dieser Zeit insbesondere die Verteilung auf Wahlveranstaltungen, an Informationsständen der Parteien sowie das Einlegen, Aufdrucken und Aufkleben parteipolitischer Informationen oder Werbemittel. Untersagt ist gleichfalls die Weitergabe an Dritte zum Zweck der Wahlwerbung. Auch ohne zeitlichen Bezug zu einer bevorstehenden Wahl darf die Druckschrift nicht in einer Weise verwendet werden, die als Parteinahme der Staatsregierung zugunsten einzelner politischer Gruppen verstanden werden könnte. Den Parteien ist es gestattet, die Druckschrift zur Unterrichtung ihrer eigenen Mitglieder zu verwenden. Diese Publikation ist urheberrechtlich geschützt, die publizistische Verwertung – auch von Teilen – der Veröffentlichung wird jedoch ausdrücklich begrüßt. Bitte nehmen Sie Kontakt mit dem Herausgeber auf, der Sie wenn möglich mit digitalen Daten der Inhalte und bei der Beschaffung der Wiedergaberechte unterstützt. Alle Rechte sind vorbehalten. Die Broschüre wird kostenlos abgegeben, jede entgeltliche Weitergabe ist untersagt. Diese Broschüre wurde mit großer Sorgfalt zusammengestellt. Eine Gewähr für die Richtigkeit und Vollständigkeit kann dennoch nicht übernommen werden. Für die Inhalte fremder Internetangebote sind wir nicht verantwortlich.



BAYERN | DIREKT ist Ihr direkter Draht zur Bayerischen Staatsregierung. Unter Telefon 089 122220 oder per E-Mail unter direkt@bayern.de erhalten Sie Informationsmaterial und Broschüren, Auskunft zu aktuellen Themen und Internetquellen sowie Hinweise zu Behörden, zuständigen Stellen und Ansprechpartnern bei der Bayerischen Staatsregierung.